

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE

KUFIZUAR "SKELA SUKAJ" SH.P.K

KREU 1

Themelimi , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia

THEMELIMI I SHOQËRISË

NENI 1

Duke u bazuar në ligjin nr 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqërite tregtare" dhe në ligjin nr 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit ",

Unë Mirsad Sukaj i biri Bilal-it i datëlindjes 03.12.1991, lindur dhe banues në Shkoder, me nr pashaporte BB8441698 dhe nr pesonal J11203060G

Unë Xhevahir Sukaj i biri Bilal-it i datëlindjes 05.10.1987, lindur dhe banues në Shkoder, me nr pashaporte BJ3788846 dhe nr pesonal I71005075Q

nën vullnetin tone të lire sot me date 26.10.2023 nënshkruajme miratimin e statutit të shoqërinë "SKELA SUKAJ" sh.p.k .

FORMA E SHOQËRISË

NENI 2

Kjo Shoqeri do jetë "Shoqeri Tregtare" e formës "Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar (sh.p.k)" "sh.p.k. Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutit të saj dhe normat e të drejtës nderkombëtare .

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 3

Kohëzgjatja e kësaj shoqërie do te jetë pa afat duke filluar nga dita e rregjistrimit në Q.K.R për njohjen dhe rregjistrimin e shoqërise si përsôn juridik.

EMËRTIMI TREGTAR I SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të quhet “.SKELA SUKAJ.” _sh.p.k dhe vula e saj ka formën drejtkëndore në të të cilën do shkruhet “SKELA SUKAJ” “sh.p.k”.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 4

Objekti i veprimtarisë ekonomike të kësaj shoqërie është :

Dhenie me qira, shitje , importim, eksportim, montim, cmontim skelash dhe aksesore skelerie. Sherbime skelerie per vepra ne formen me te gjere dhe ne te gjitha fushat, civile, industriale tregtare, publike dhe private, ne ndertime, rikonstruksione, restaurime, fasada etj

SELIA E SHOQËRISË

NENI 5

Kjo shoqëri do ketë selinë e vet në adresën Shkoder Rrethina SHTOJ I RI Rruga e Sektorit, Kati I-re, zona kadastrale 3428 , nr pas 107/20

KREU 2

Kapitali Themeltar, Organet e Shoqërise , Administratori ,Eksperti Kontabël dhe Prishja e Shoqërisë

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar është në 5,000,000 Lekë (pese milion) dhe përfaqësohet nga kontributi i anëtarëve themelues, i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale të një kuote prej 2,500,000 Lekë (dy million e peseind mije leke) . Ortaket themelues te Shoqërisë zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si mëposhtë:

- Z.Mirsad Sukaj , me vlere kapitali 2,500,000 Lekë (dy milion e peseqind mije leke) , zotëron 1 kuotë korensponduese me 50% (qind) të kapltalit të shoqerisë .
- Z.Xhevahir Sukaj , me vlere kapitali 2,500,000 Lekë (dy milion e peseqind mije leke) , zotëron 1 kuotë korensponduese me 50% (qind) të kapltalit të shoqerisë .

Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe çdo lloj valute tjetër në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiarë të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe administratori të caktuar nga shoqëria depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në bankat ku është çelur llogaria.

NENI 7

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të kodit civil dhe atij tregtar.

Asambleja e ortakëve ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e saj përfshirë edhe fondet e kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të jenë të vërtetuara me akt noterial dhe për një gjë të tillë asambleja e përgjithshme duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, vendim i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme shoqëria ka të drejtën që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ia tjetërsojë një apo disa personave fizikë jashtë shoqërisë ose personave juridik, vendas apo të huaj mbi bazën e Aktit noterial të tjetërsuar .

Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme për ndryshim të kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë QKR-së.

NENI 9

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet para kërkesës së drejtuar në QKR për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Pjesët e kapitalit mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht .

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 10

Asamblea e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë dhe ajo ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për shoqëritë tregtare: i njez asamblesë së ortakëve.

Asamblea e përgjithshme mund t'ja delegojë kompetencat një ose shumë administratoreve caktuar prej saj dhe njez personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërië vetëm mbi bazën e prokurës.

NENI 11

Me vendim të Asamblesë shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda dhe jashtë vendit.

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë vendos:

- ❖ Mbi ndryshimet në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë
- ❖ Mbi formimin e filialeve degëve dhe përfaqësive jashtë vendit
- ❖ Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themeltar
- ❖ Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera
- ❖ Mbi transferimin dhe revokimin e likuidatorëve
- ❖ Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare
- ❖ Mbi emërimin dhe shkarkimin e Administratorit

NENI 12

Kjo shoqëri administrohet nga administratori Z. Mirsad Sukaj i cili emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ndryshimi me konsesusin e ortakëve.

EKSPERTI KONTABËL

NENI 13

Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen me datë 31 dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabël mbi bazën e aktivitetit dhe pasivitetit ngarkohet nga asambleja e përgjithshme një ekspert kontabël i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë akt gjithvletor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë nga ana e asamblesë..

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël I autorizuar përgatit me shkrim, nxjerrjen rezultatit të bilancit vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara e cila është e detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

NENI 14

Nxjerrja e rezultateve të bilancit vjetor duhet bërë me saktësi duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen nga ligji për kontabilitetin dhe atyre të sistemit të taksave që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtari tregtare.

NENI 15

Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asmablesë së Përgjithshme e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj duke patur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

NENI 16

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyrjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë sado qofshin ato.

PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 17

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakku edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar siç mund të jënë, Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për falimentimin"

Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto raste Asmbleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose disa likuidatore dhe duke shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij dhe emertesën "Shoqëri në likuidim e sipër".

NENI 18

Afati i emërimit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashtron ligji përkatës duke speciikuar dhe dokumentet që duhen depozituar në aneksin e regjistrit në QKR.

NENI 19

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet vendimeve plotësuese dhe të ligjshme, dhënë nga Asambleja e Përgjithshme si dhe legjislacioni në fuqi.

ORTAKET E SHOQËRISË

MIRSAD SUKAJ

XHEVAHIR SUKAJ

MIRSAD SUKAJ

XHEVAHIR SUKAJ